



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 31 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Shtatë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(1) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionin e Mbrojtjes për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar, më 1 nëntor 2021 u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar, F00098/A01, konfidenciale; dhe më 16 nëntor 2021 u dorëzua versioni i redaktuar publik i aktakuzës së korrigjuar, F00107/A01.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me To (“Vendimi Kornizë”).⁷
5. Më 4 mars 2022, u mbajt konferenca e gjashtë mbi ecurinë e çështjes.⁸ Në atë konferencë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, caktoi datën 31 maj 2022 si datë paraprake për kalimin e dosjes Trupit Gjykues dhe miratoi kalendarin për një numër pikash të mbetura në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë tij, dhe u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen garancitë mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.
7. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve sipas rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen të dorëzojë dosjen paraprake brenda një afati të përcaktuar. Gjithashtu, brenda një afati

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me To*, 30 prill 2021, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00140, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrimet*, 9 shkurt 2022, publik (“Urdhri i datës 9 shkurt 2022”), para. 12, 15(b). Konferenca e parë, e dytë, e tretë, e katërt dhe e pestë mbi ecurinë e çështjes u mbajtën përkatësisht më 23 prill 2021, 21 qershor 2021, 23 shtator 2021, 15 nëntor 2021 dhe 14 janar 2022.

⁹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 242-243.

të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabimet faktike ose ligjore.

8. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, në vijim të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes pas paraqitjes së parë të akuzuarit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nëse e gjykon të nevojshme, mbledh konferenca mbi ecurinë e çështjes për: (i) organizimin e shkëmbimeve mes palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe për t'u dhënë palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, mundësinë e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

9. Sipas rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; ose (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës i bëhet drejtpërdrejt Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës të Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), paraprakisht e në kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, ndër të cilat informimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

10. Sipas rregullës 98 të Rregullores, pas marrjes së parashtrimeve nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja bazuar në rregullat 95(4) dhe (5) dhe 97 të Rregullores dhe brenda tridhjetë (30) ditësh pas daljes së çdo vendimi të formës së prerë në lidhje me

mocione paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kalon trupit gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore.

III. DISKUTIM

11. Pas shqyrtimit të mendimeve të shprehura nga palët dhe mbrojtësi i viktimave në lidhje me datën e mbajtjes së konferencës së shtatë mbi ecurinë e kësaj çështjeje gjyqësore,¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos që konferenca e shtatë mbi ecurinë e çështjes të mbahet të enjten, më 14 prill 2022, në orën 9:30.

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin informacion të përditësuar, nëse kanë, në lidhje me pikat ende të pazgjidhura të specifikuara në rendin e ditës të konferencës së gjashtë mbi ecurinë e çështjes,¹¹ dhe të bëjnë parashtrime me shkrim dhe me gojë në lidhje me ato pika.¹² Gjithashtu, sipas rastit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve dhe/ose mbrojtësit të viktimave informacion të përditësuar për pikat e mëposhtme:

(1) Nxjerrja e materialit

(a) a mundet ZPS-ja të bëjë të ditur nëse ka mbetur ndonjë pikë ende e pazgjidhur në lidhje me nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, me përjashtim të materialeve që janë objekt i kërkesës së saj sipas rregullës 102(2) të Rregullores;¹³

¹⁰ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 243.

¹¹ Urdhri i datës 9 shkurt 2022, para. 13.

¹² KSC-BC-2020-04, F00150, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 shkurt 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 21 shkurt 2022), F00150/RED); F00153, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime në Përputhje me Urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të Datës 9 shkurt 2022 në lidhje me Konferencën e Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes*, 22 shkurt 2022, publike ("Parashtrimet e Mbrojtjes për Konferencën e Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes").

¹³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 194-200; F00169, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe për Ndryshimin e Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 25 mars 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 mars 2022, F00169/RED).

(b) a mundet: (i) Mbrojtja të bëjë të ditur nëse ka kërkuar materiale të tjera nga njoftimi i ZPS-së sipas rregullës 102(3) të Rregullores që përmban përkrahje të rishikuara pjesërisht dhe, nëse po, a janë nxjerrë ato materiale;¹⁴ (ii) ZPS-ja të bëjë të ditur kur do të nxirren materialet e lartpërmendura në rast se kjo nuk është bërë deri tani; dhe (iii) palët të bëjnë të ditur nëse ka pika të tjera ende të pazgjidhura në lidhje me materialet që janë objekt i rregullës 102(3) të Rregullores, me përjashtim të kërkesës së ZPS-së për ndryshimin e njoftimit sipas rregullës 102(3) të Rregullores;¹⁵

(c) a mundet ZPS-ja të bëjë të ditur nëse ka ende prova shfajësuese në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të saj, të cilat duhet t'i nxirren Mbrojtjes në pajtim me rregullën 103 të Rregullores, me përjashtim të materialeve që janë objekt i kërkesave për masa mbrojtëse;¹⁶

(d) a ka bërë përparim ZPS-ja në procesin e nxjerrjes së materialeve që janë objekt i kufizimeve sipas rregullës 107 të Rregullores, me përjashtim të kërkesës së lartpërmendur për ndryshimin e njoftimit sipas rregullës 102(3) të Rregullores;¹⁷

(e) a mundet ZPS-ja të bëjë të ditur nëse do t'i përmbushë të gjitha detyrimet në lidhje me nxjerrjen e materialeve gjatë fazës paraprake jo më vonë se 22 prilli 2022, me përjashtim të materialeve që janë objekt i kërkesave për masa mbrojtëse;¹⁸

(f) a mundet Mbrojtja të bëjë të ditur, jo më vonë se 22 prilli 2022, nëse, në përputhje me rregullën 95(2)(e) të Rregullores, kundërshton ose synon të

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00167, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) me Përkrahje të Rishikuara Pjesërisht*, 18 mars 2022, publik, me shtojcën konfidenciale 1.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 203-211; F00170, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Ndryshimin e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 25 mars 2022, publike.

¹⁶ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 211-214.

¹⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 214-215.

¹⁸ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 242.

kundërshtojë pranueshmërinë e cilitdo materiali provues të nxjerrë në bazë të rregullës 102 të Rregullores;¹⁹

(g) a kanë bërë përparim palët në diskutimet mes tyre për krijimin e rubrikave të dëshmitarëve në sistemin *Legal Workflow*;²⁰

(h) a po përballen apo parashikojnë të përballen palët me ndonjë vështirësi në lidhje me procesin e nxjerrjes së materialeve të përcaktuar në Vendimin Kornizë.

(2) Përkthimet

(a) a kanë bërë palët ndonjë kërkesë për t'i dhënë përparësi përkthimit të parashtrimeve apo materialeve provuese specifike; a është bërë ndonjë përparim në lidhje me këto kërkesa, dhe/ose a janë hasur vështirësi në këtë aspekt.²¹

(3) Hetimet e ZPS-së

(a) a mund të japë ZPS-ja më shumë informacion në lidhje me hapat hetimorë shtesë të ndërmarrë dhe kur do të përfundojnë këto hapa.²²

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm

(a) Bazuar në vlerësimet e ZPS-së dhe procesin në vijimësi të nxjerrjes së materialeve, a mund të japë Mbrojtja më shumë informacion mbi ecurinë e hetimeve të saj, synimin për të bërë kërkesa lidhur me mundësitë hetimore unike në përputhje me rregullën 99(1) të Rregullores, dhe për kohën që parashikon se do t'i duhet për të përfunduar hetimet e saj;²³

¹⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes për Konferencën e Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes, para. 13.

²⁰ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 200-203.

²¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 215-217.

²² KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 217-225.

²³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 225-229.

(b) a mund të bëjë të ditur Mbrojtja nëse synon të japë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe të nxjerrë materialet përkatëse sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores;²⁴

(c) a parashikon Mbrojtja dorëzimin e dosjes paraprake dhe materialeve përkatëse sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe, nëse po, kur mendon se do të jetë në gjendje t'i dorëzojë ato, duke pasur parasysh datën paraprake për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues.²⁵

(5) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen

(a) a i kanë përfunduar palët diskutimet mes tyre në lidhje me mundësinë për të paraqitur pikat juridike dhe/ose faktike për të cilat pajtohen, në përputhje me rregullat 95(3) dhe 156 të Rregullores, apo a mund të konfirmojnë se një marrëveshje e tillë nuk do të arrihet përpara datës së parashikuar për kalimin e dosjes së çështjes.²⁶

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron më tej ZPS-në, mbrojtësin e viktimave dhe Mbrojtjen që deri të hënën, 11 prill 2022 (ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave) dhe të martën, 12 prill 2022 (Mbrojtja), të dorëzojnë parashtrime me shkrim për cilëndo nga pikat në paragrafin 12 të këtij urdhri (sipas rastit), si edhe për temat e diskutuara gjatë konferencës së gjashtë mbi ecurinë e çështjes, për çfarëdo pike tjetër që nuk është përfshirë në rendin e ditës së konferencës së gjashtë dhe të shtatë mbi ecurinë e çështjes, për çfarëdo vështirësie të hasur lidhur me nxjerrjen e materialit provues, apo për çfarëdo pike tjetër që ka lidhje me to.

²⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 227.

²⁵ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 227.

²⁶ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 229-232, 243.

IV. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **VENDOS** të mbajë konferencën e shtatë mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, Mbrojtjes dhe mbrojtësit të viktimave të **enjten, më 14 prill 2022, në orën 9:30**; dhe

(b) **URDHËRON** ZPS-në, mbrojtësin e viktimave dhe Mbrojtjen që, deri të **hënën, më 11 prill 2022, në orën 16:00** (ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave) dhe **të martën, më 12 prill 2022, në orën 16:00** (Mbrojtja), të dorëzojnë parashtrime me shkrim në lidhje me pikat në paragrafët 12 dhe/ose 13 të këtij urdhri.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 31 mars 2022

Në Hagë, Holandë.